

T & C SH.P.K.
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

T & C SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014

AKTIVE	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	2,059,566	2,319,915
Llogari të arkëtueshme	5	6,626,695	4,007,470
Inventari	6	2,890,265	3,461,216
Aktive të tjera afatshkurtra	7	1,316,043	3,919,476
Total Aktiveve Afatshkurtra		12,892,569	13,708,077
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	8	570,118	667,644
Total aktive afatgjatë		570,118	667,644
Total Aktive		13,462,687	14,375,721
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	9	10,279,113	9,617,813
Parapagimet e arkëtueshme	10	524,412	-
Llogari të pagueshme të tjera	11	15,965,490	13,957,242
Total Detyrime afatshkurtra		26,769,015	23,575,055
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	12	1,611,610	1,612,300
Total Detyrime afatgjatë		1,611,610	1,612,300
Totali i detyrimeve		28,380,625	25,187,355
Kapitali aksionar			
Kapitali	13	200,000	200,000
Rezerva të tjera		1,142,480	1,142,480
Rezerva ligjore		20,000	20,000
Fitime të mbartura		(12,174,114)	(8,099,472)
Fitimi i ushtrimit		(4,106,304)	(4,074,642)
Total kapitali		(14,917,938)	(10,811,634)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		13,462,687	14,375,721

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

T & C SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Te ardhura	14	12,527,246	29,352,649
Te ardhura te tjera		-	62,775
Materiale te para dhe te konsumueshme	15	(7,890,120)	(25,024,947)
Shpenzime personeli	16	(7,941,446)	(7,072,823)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	8	(151,192)	(162,754)
Shpenzime te tjera	17	(645,912)	(995,890)
Fitimi operativ		(4,101,424)	(3,840,990)
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	18	(4,880)	(233,652)
Total shpenzime financiare		(4,880)	(233,652)
Fitimi para tatimit		(4,106,304)	(4,074,642)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	-	-
Fitimi i vitit		(4,106,304)	(4,074,642)
Te ardhura te tjera te pergjithshme		-	-
Totali i te ardhurave te pergjithshme		(4,106,304)	(4,074,642)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

T & C SHPK
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	200,000	-	-	(6,936,992)	(6,736,992)
Fitimi i vitit				(4,074,642)	(4,074,642)
Transferim ne rezerva te tjera		1,142,480	20,000	(1,162,480)	-
31 Dhjetor 2013	200,000	1,142,480	20,000	(12,174,114)	(10,811,634)
Fitimi i vitit				(4,106,304)	(4,106,304)
31 Dhjetor 2014	200,000	1,142,480	20,000	(16,280,418)	-(14,917,938)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë T & C sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 30 Mars 2015 nga:


Genc Sokolaj
Administrator
 T & C
 Sh.p.k.
 Prizren, Albania
 Makineri Paisje Ndërtimi


Bernard Gromashi
Mazars Sh.p.k

T & C SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Paasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014

	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(4,106,304)	(4,074,642)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	151,192	162,754
Shpenzime për interesa	(130)	271
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar	570,951	(2,157,923)
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(15,792)	2,857,016
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	2,669,548	6,775,110
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra	524,412	
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	(206,123)	3,562,586
Interesa te paguara	130	(271)
	130	(271)
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata material	(53,666)	(90,157)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	(53,666)	(90,157)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate agjatgjata	(690)	(1,314,855)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	(690)	(1,314,855)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(260,349)	2,157,303
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	2,319,915	162,612
Mjetet monetare ne fund te periudhës	2,059,566	2,319,915

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "T&C" Shpk është regjistruar pranë QKR në 26/11/2009. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr. 7638 dt. 19 Nentor 1992 "Per shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti i saj.

"T&C" Shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Kapitali i shoqërisë "T&C" Shpk është 200,000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 2,000 Leke secila,

"T&C" sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- C.O.M.A.R zoterues i 50 kuotave ose 50 % të kapitalit të shoqërisë;
- TREMA TECH zoterues i 50 kuotave ose 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë, duke filluar nga data 26.11.2009 është z. Genc Sokolaj.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është Import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial dhe ushqimorë të gjitha llojeve me shumicë e pakicë. Tregtim automjetesh të çdo lloji dhe makinerive të ndërtimit si dhe pjesëve të këmbimit për këto automjete e makineri. Kryerja e shërbimeve për automjetet dhe makineritë e ndërtimit (Servis).

Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të jetë pa ndërprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Durrësit", Sheshi "Karl Topia", pallati 127, kulla 1, Kati II, Tiranë.

Ajo është regjistruar në Degen e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT K92326018D.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjve gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktive afatgjata materiale

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%
Ndertesa	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivitetin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektive.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare ne banke	19,106	915,637
Llogari rrjedhese	19,106	915,637
Mjete monetare ne arke	2,040,460	1,404,278
	<u>2,059,566</u>	<u>2,319,915</u>

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente ne All	103,256	103,312
Kliente ne Euro	6,523,439	3,904,158
	<u>6,626,695</u>	<u>4,007,470</u>

T & C SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)***6. INVENTARI**

Gjendjet e Inventarit me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 jane si me poshte :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Lende e pare dhe materiale	684,574	600,716
Mallra per rishitje	2,205,691	2,860,500
Totali	<u>2,890,265</u>	<u>3,461,216</u>

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shteti TVSH për tu rregulluar	-	113,984
Detyrime doganore	177	221
Tatim Fitimi	151,948	151,948
T & C Kosova	47,732	47,752
Trema Tech	704,386	3,193,599
Trema Engineering 2	400,800	400,972
Garanci Vodafone	11,000	11,000
Totali	<u>1,316,043</u>	<u>3,919,476</u>

T & C SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

8. AKTIVE AFATGJATA

	Makineri Pajisje	Automjetet	Instrumenta vegla pune	Paisje Kompjuterike	Te Tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	299,000	183,003	93,386	211,446	204,124	990,960
Shtesa		71,490		18,667		90,157
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	299,000	254,493	93,386	230,113	204,124	1,081,116
Shtesa				53,666		53,666
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	299,000	254,493	93,386	283,779	204,124	1,134,782
Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	136,344	8,006	8,696	58,812	38,860	250,718
Amortizimi i vitit	32,531	38,574	16,938	41,658	33,053	162,754
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	168,875	46,580	25,634	100,470	71,913	413,472
Amortizimi i vitit	26,025	41,583	13,551	43,591	26,442	151,192
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	194,900	88,163	39,185	144,061	98,355	564,664
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	162,656	174,997	84,690	152,634	165,264	740,242
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	130,125	207,913	67,752	129,643	132,211	667,644
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	104,100	166,330	54,201	139,718	105,769	570,118

9. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Furnitore All	294,459	352,534
Furnitore Euro	9,972,441	9,238,594
Furnitore për fatura të pa mberitura All	12,213	26,685
	<u>10,279,113</u>	<u>9,617,813</u>

10. PARAPAGIMET E ARKETUARA

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Parapagim në klient	524,412	-
	<u>524,412</u>	<u>-</u>

11. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Detyrimet të tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga për t'u paguar	13,588,364	12,410,780
Sigurime shoqërore & shëndetësore	510,657	106,166
Tatimin mbi të ardhurat personale	336,915	69,990
Tatim në burim	178,962	178,962
TVSH për t'u paguar	159,278	-
Financime nga Genc Sokolaj	654,954	654,984
Debitore & kreditore të tjera	536,360	536,360
	<u>15,965,490</u>	<u>13,957,242</u>

12. DETYRIME TË TJERA AFATGJATA

Në këtë zë është paraqitur detyrimi që ka shoqëria ndaj ortakut të shoqërise. Më poshtë është paraqitur ky detyrim për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2013 :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Comar	1,611,610	1,612,300
	<u>1,611,610</u>	<u>1,612,300</u>

13. KAPITALI AKSIONAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 200,000 Leke.

14. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga shitja e Gjeneratoreve dhe pjeseve	7,430,766	25,054,544
Te ardhura nga Kryerja e Sherbimit te riparimeve	5,096,480	4,298,105
	<u>12,527,246</u>	<u>29,352,649</u>

Rakordimi i te ardhurave te deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar ne FDP e TVSH eshte si me poshte:

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne e Tatim Fitimit	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	13,191,868
Autofaturim Vei 2014	(140,210)
Parapagim 2014	(524,412)
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH	<u>12,527,246</u>
Fitim nga kembimet valutore	31,466
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	<u>12,558,712</u>

15. LENDET E PARA DHE SHERBIMET

Kosto e materialeve te para dhe te tjera te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kosto e materialeve te para	2,251,365	1,886,393
Dieta	667,903	876,399
Kosto e mallrave te shitur	4,121,247	21,041,215
Nenkotraktore	-	540,277
Mirembajtje dhe riparime makinerite dhe fabrika	86,127	55,533
Qera	480,000	120,000
Prime sigurimi	45,333	32,250
Shpenzime Komunikimi	164,361	230,567
Shpenzime per Update Soft	-	56,180
Transporte & Agjensi Doganore	73,784	186,133
	<u>7,890,120</u>	<u>25,024,947</u>

16. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per paga	7,173,975	6,838,800
Shpenzime per sigurime shoq e shend	767,471	234,023
	<u>7,941,446</u>	<u>7,072,823</u>

17. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane te analizuara si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime administrative dhe noteriale	15,133	12,550
Konsulenca ekonomike dhe juridike	210,154	419,475
Blerje te ndryshme,kancelari etj	31,258	39,887
Komisione bankare	109,781	185,108
Pritje Percjellje Dhurata	-	51,046
Taksa te ndryshme	98,995	66,444
Gjoha te ndryshme	17,888	124,750
Te tjera	-	22,800
Shpenzime te ndryshme dhe te panjohura	162,703	73,830
	<u>645,912</u>	<u>995,890</u>

18. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane analizuar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per interesa	-	(379)
Te ardhura nga interesat	130	108
Humbje nga kembimet valutote	(36,346)	(317,352)
Te ardhura nga kembimet valutore	31,336	83,971
	<u>(4,880)</u>	<u>(233,652)</u>

19. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri,norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore. Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>	<u>Dhjetor 31, 2013</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	(4,106,304)	(4,074,642)
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	184,791	213,016
Shpenzime pritje & percjellje		10,202
Penalitet, gjoba e demshperblime	17,888	124,750
Shpenzime te tjera	162,703	73,831
Dieta mbi normen e lejuar	4,200	4,233
<i>Fitimi Tatimor</i>	(3,921,513)	(3,861,626)
	(3,921,513)	(3,861,626)
<i>Tatim fitimi 15%,10%</i>		
	(4,106,304)	(4,074,642)

20. TRANSAKSIONE ME PALE TE LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve, ose detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse vendoset apo jo një çmim.

Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare; ka një interes mbi njësinë që i jep një influencë të rëndësishme mbi entitetin; ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin; është ortak në shoqëri; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës; ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose mëmës së tij (duke përfshirë familjarët e afërm të çdonjërit prej individëve të sipërpërmendur).

Gjate vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2014 Kompania ka kryer transaksione me pale te lidhura, te cilat rezultojne ne shumat e me poshtme:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Të arketushme nga palët e lidhura		
Trema Tech	25,236	25,110
	25,236	25,110
	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Të tjera te arketushme nga palët e lidhura		
Trema Tech	704,384	3,193,599
	704,384	3,193,599
	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Të pagueshme ndaj palëve e lidhura		
C.O.M.A.R S.P.A.	4,263,680	1,612,300
	4,263,680	1,612,300

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura C.O.M.A.R S.P.A.	1,611,610	1,612,300
	<u>1,611,610</u>	<u>1,612,300</u>

21. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

22. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.